



TrafikuUrban  
PRISHTINË



## STATUTI

### I

## NDËRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE TRAFIKU URBAN – SHA PRISHTINË

Prishtinë, Mars ` 2013

Nr. 847 data 25.09.2013

Në bazë të dispozitave të neneve 35 dhe 137 të Ligjit nr. 02/L -123, për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 39/1, tetor 2008), të dispozitave të nenit 15 të Ligjit nr. 04/L - 006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L - 123 për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 6/22, korrik 2011), të dispozitave të nenit 4, paragrafet 4.1 dhe 4.2 të Ligjit nr. 03/L - 087 për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15, qershor 2008), Komisioni komunal i Aksionarëve i Komunës së Prishtinës për ndërmarrjen publike komunale "Trafiku Urban" SH.A., në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_, miratoi këtë

## STATUT

TË

### NDËRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE "TRAFIKU URBAN" SH.A., PRISHTINË

#### I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### 1.Qëllimi

###### Neni 1.

- Me këtë Statut caktohen parimet themelore për organizimin dhe punën e ndërmarrjes publike komunale "Trafiku Urban", SH.A., në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë).
- NPK "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë, ka statusin e ndërmarrjes publike komunale , e cila mund të paditet dhe të padisë, të posedojë të udhëheq dhe t'i përcaktojë kushtet e udhëheqjes dhe shfrytëzimit të pasurisë së saj, të lidhë kontrata, të punësojë dhe të largojë punonjës nga ndërmarrja dhe të angazhohet në aktivitete të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj dhe akte nënligjore.

##### 2. Baza ligjore dhe emërtimi

###### Neni 2.

- Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L - 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, "Trafiku Urban" SH.A. nga Prishtina është paraparë në listën 2, ku janë caktuar ndërmarrjet publike lokale në nivel të Kosovës.
- Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij nenit, "Trafiku Urban", veprimtarinë e tij do ta ushtrojë me emërtimin: Ndërmarrja publike komunale " Trafiku Urban", SH.A., Prishtinë.
- Emërtimi i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2 të këtij nenit është: NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë.

##### 3. Selia

###### Neni 3.

Selia e NPK "Trafiku Urban" ", SH.A., Prishtinë, është në Prishtinë, rruga "Tahir Zajmi" pn .

##### 4.Vula dhe emblema

###### Neni 4.

1. NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, ka vulën e vet, të rrumbullakët dhe katrore.

2. Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:

- a) Rrethi i parë: *Komuna e Prishtinës*;
- b) Rrethi i dytë: *NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë dhe*
- c) Në mes të vulës është *emblema*.

3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me përmbajtje:

- a) *NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë*;
- d) *Njësia organizative, numri dhe data*.

4. Përmbajtja në vullat e NPK "Trafiku Urban" SHA, Prishtinë, duhet të jetë e shkruar në gjuhët zyrtare sipas, Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

## 5. Kohëzgjatja

**Neni 5.**

1. Kohëzgjatja e NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë si shoqëri aksionare, është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe dispozitat tjera.

2. Nëse kohëzgjatja e ndërmarrjes ndryshohet, për këtë duhet të njoftohet Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë dhe të kërkohet që kjo të publikohet nga ana e Agjencisë në bazën e të dhënave të saj.

## II. DISPOZITAT E VEÇANTA

### 1. Fushëveprimtaria

**Neni 6.**

Fushëveprimtaria e ndërmarrjes është:

1. Veprimtaria kryesore - primare e NPK "Trafiku Urban" SH.A në Prishtinë është Transporti Publik i Udhëtarëve në komunikacionin rrugor, në vijat urbane, urbano - periferike dhe Ndérurbane ( në shifren nr.6021 dhe 6023 ).

2. Veprimtarit sekundare të ndërmarrjes janë :

- 2.1. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, për nevoja të ndërmarrjes dhe përsonavë të tretë ( në shifren nr. 5020 )
- 2.2. Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta dhe të lëngëta dhe produkteve që fitojnë prej tyre (në shifren 51.51).
- 2.3. Shërbime hoteliere (në shifren 55.12 ) dhe
- 2.4. Veprimtari të agjensive të udhëtimit dhe shërbime të tjera për turist(në shifren 63.30).

## **2. Themeluesi i NPK - së**

### **Neni 7.**

1. Komuna e Prishtinës është pronare e ndërmarrjes, me aksione në pronësinë e saj.
2. NPK "Trfiku Urban" SH.A., Prishtinë, është trashëgimtare e OTHPB - së për komunikacionin rrugor, në linjat urbane dhe urbano- periferike gjërë më 01.04.1976 , rrespektivisht KPK "Trafiku Urban" në Prishtinë.
3. NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, themelohet pas regjistrimit të Statutit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, sipas dispozitave të Ligjit për shoqëritë tregtare.

## **3. Statuti dhe rregulloret**

### **Neni 8.**

1. NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, miraton Statutin si aktin themelor të saj. Statuti miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Komisioni komunal i Aksionarëve i NPK "Trafiku Urban", SH.A., Prishtinë dhe dorëzohet në organin për regjistrim të shoqërive tregtare pranë MTI - së.
2. Komisioni komunal i Aksionareve të NPK "Trafiku Urban", SH.A., Prishtinë, në pajtim me këtë statut, dispozitat e ligjeve në fuqi dhe modelin e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e miraton, e ndryshon dhe e plotëson Kodin e etikës.
3. Rregulloret dhe aktet tjera të NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, miratohen, ndryshohen dhe plotësohen nga Bordi i drejtoreve i NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, në pajtim me dispozita të nenit 138 të Ligjit nr. 02/L -123 për shoqëritë tregtare dhe të nenit 20 të Ligjit nr. 04/L - 111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 087, për ndërmarrjet publike.
4. Në rast konflikti në mes të dispozitave të Statutit dhe të akteve tjera qeverisëse të NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, do të zbatohen dispozitat e këtij Statuti.

## **4. Përgjegjësítë**

### **Neni 9.**

1. Komisioni komunal i Aksionareve, Bordi i drejtoreve dhe stafi i NPK "Trfiku Urban" SH.A., Prishtinë, është përgjegjëse për pasurinë që gjëzon ajo, të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rezultat i këtij transformimi.
2. Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër, nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është kontraktues në këtë shoqëri.

## **5. Përgjegjësítë e themeluesve për veprimet para regjistrimit**

### **Neni 10.**

Nëse janë ndërmarrë veprime në emër të ish - ndërmarrjes para regjistrimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në hapjen e xhilologarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve të tjera, pasi Shoqëria të jetë regjistruar, ajo merr përsipër përgjegjësinë për këto detyrime dhe në raste të tillë, NPK " Trafiku Urban " SH.A., Prishtinë, është e vetmja palë përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet.

## **6. Kapitali**

### **Neni 11.**

1. Kapitali themeltar i NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, si shoqëri është 25.000,00, (njëzetepesë mijë euro) € dhe është i ndarë në 25.000,00 (njëzetepesë mijë) aksione me vlerë nominale një (1) € secili.

2. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas Ligjit për shoqëritë tregtare, ku përfshihen, shuma, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve etj.

## **7. Aksionet**

### **Neni 12.**

1. NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, do të ketë listën e aksionareve.
2. Aksionet janë të formës nominale, të thjeshta ose të privilegjuara, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë dhe të transferueshme lirisht, sipas legjislativit në fuqi të Republikës se Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.
3. Vlera e aksionit të thjeshtë të shoqërisë është: një (1) €.
4. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit, në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.
5. Aksionet e shoqërisë zotërohen në masën 100% nga Komuna e Prishtinës.

## **8. Aksionarët**

### **Neni 13.**

Regjistri i aksionarëve:

- a) NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, themelon dhe mirëmban regjistrin e aksionarëve, në pajtueshmëri me ligjin. Regjistrat e tillë duhet të përmbajnë informatat e kërkuar në bazë të ligjit, si dhe çfarëdo informate tjeter që ndërmarrja e sheh si të nevojshme;
- b) NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, nuk do t'i ngarkojë me taksë për regjistrimin e çfarëdo transferi apo dokumenti tjeter në lidhshmëri me/apo, i cili dëmton titullin e ndonjë aksioni;
- c) Sekretari mund të regjistrojë transferin e ndonjë aksioni vetëm kur t'i ofrohet dëshmia mbi transferin në pajtueshmëri me Ligjin;
- d) Sekretari duhet të lejon aksionarët, të tjerët që parashihen me ligj, si dhe agjentët e tyre relevantë të autorizuar, të shikojnë regjistrin e aksionarëve, dhe duhet të i'u ofrojë atyre ekstrakte (fragmente) relevante nga regjistri, sipas kërkesës së tyre.

Mbledhja e Aksionarëve:

- a) Mbledhja e aksionarëve të NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë, është organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes. Vendimet e mbledhjes së aksionarëve janë

detyruese për ndërmarrje, Bordin e drejtoreve të ndërmarrjes, si dhe zyrtarët e ndërmarrjes.

b) Thirrja dhe rendi i ditës së mbledhjes, njoftimi i mbledhjes dhe procedimet, kuorumi për mbledhje udhëheqësi i mbledhjes, votat e aksionarëve dhe kompetencat e mbledhjes për rregullohen me akt të veçantë, në pajtim me dispozitat e nenit 138 të Ligjit për shoqëritë tregtare.

#### 9. Shpërndarja e dividendifit

Neni 14.

1. Bordi i drejtoreve të ndërmarrjes përcakton dividendifit.
2. Shpërndarja e saj do te behet vetëm me autorizim të aksionarit, sipas përcaktimit të Ligjit për shoqëritë tregtare.

#### 10. Bordi i drejtorëve

Neni 15.

1. Funksioni i Bordit të drejtorëve:  
Kompetencat dhe përgjegjësitë e NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë do të ushtron nga Bordi i drejtorëve, ashtu siç është përcaktuar me ligj, statutin e NPK "Trafiku Urban" SH.A., Prishtinë dhe nga aktet të cilat vetë i ka miratuar.

#### 2. Anëtarët e Bordit të drejtorëve:

Bordi i parë i drejtorëve, i zgjedhur nga Komisioni komunal i Aksionareve në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, është në këtë përbërje:

- Albione Maloku nga Prishtina, me nr. personal 1000974753 Kryesuese e Bordit të Drejtorëve.
- Rizah Krasniqi nga Prishtina, me nr. personal 2004067867, Kryesues i komisionit të auditimit.
- Mustafë Hasani nga Ferizaji, me nr. personal 2005006557, anëtar i komisionit të auditimit, dhe
- Zijadin Krasniqi nga Prishtina, me nr. personal 1001076155, anëtar i komisionit të auditimit.
- Hafir Hamiti, nga Prishtina, me nr. personal 2001198737, ud.kryeshef ekzekutiv.

#### 3. Bordi i drejtorëve ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Të respektojë ligjet, statutin e ndërmarrjes, aktet të tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit komunal të Aksionareve, në pajtueshmëri me ligjin;
- b) Të përcaktojë, dhe së paku çdo tre muaj të rishikojë strategjinë e ndërmarrjes;
- c) Të përgatisë dhe të miratojë strategjinë afatgjate, investimet dhe planet financiare të ndërmarrjes dhe, brenda afatit relevant kohor, të rishikojë atë kurdo që është e

nevojshme, së paku në çdo tre muaj, të bëj ndryshime, të cilat mund të jenë të nevojshme;

- d) Të miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, të përgatitur nga KE, në bazë të planit afatgjatë;
- e) Të emërojë, largojë apo zëvendësojë KE, të përcaktojë, me propozim të Komisionit të auditimit kompensimin e tij ose saj, dhe të sigurojë që procesi përzgjedhjen e KE do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë shoqërisë disponueshmërinë e talentëve dhe kompetencave adekuate;
- f) Të përcaktojë rastet, përkatësisht çështjet dhe transaksionet, të cilat nuk janë në kompetencë të KE, përkatësisht ka fuqi të kufizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur në kuptim të dispozitave të nenit 192.1 pika c, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
- g) Të emërojë dhe largojë ZKFTH dhe sekretarin, dhe në bazë të propozimit të Komisionit të auditimit, të përcaktojë kompensimin e tyre;
- h) Të përcaktojë, me propozim të KE, transaksionet financiare, në bazë të të cilave KE nuk do të ketë fuqinë të veprojë (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur, dhe do të duhejë të kërkojë autorizim paraprak nga KE, apo nga Bordi i drejtoreve;
- i) Të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi punën e biznesit të ndërmarrjes, mbi punën e KE, ZKFTH dhe sekretarit, mbi organizimin e brendshme të ndërmarrjes dhe mbi përfomancen e ndërmarrjes, dhe të sigurojë se linjat e raportimit të ndërmarrjes janë të organizuara për të lejuar performancën dhe, mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e zyrtarit të auditimit të brendshëm, vetëm me propozim të Komisionit të auditimit);
- j) Të miratojë, në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrrafë vonese dhe në çfarëdo rasti brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të vitit finanziarë të ndërmarrjes:
  - Bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të ndërmarrjes, dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohet me ligj;
  - raportin vjetor të menaxhimit, rregulloret e biznesit, gjendjen financiare të ndërmarrjes do të duhejë të përfshijë vështrimet, në atë mënyrë që pëforma e ndërmarrjes të mund të barazohejë me planet afatgjata dhe të paraqesë propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mbulimin e humbjeve;
  - deklaratën për aksionarët që, sipas njohurive më të mira të Bordit të drejtoreve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të auditimit dhe sipas hetimit të vetë të pavarur dhe të kujdesshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendor asnjë informatë apo pasqyrë e që mos përfshirja e tyre do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë - së bashku me raportin nga Auditori i jashtëm në dokumentet e parashtruara (i) - tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para datës së mbledhjes së Komisionit komunal të Aksionareve;
- k) Të sigurojë që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financier dhe procedurat janë në vendin e duhur;
- l) Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e ndërmarrjes, duke përfshirë regjistrat

- financiarë, mbahen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi, dhe propozimraportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet;
- m) Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga Auditori i jashtëm;
  - n) Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuatë janë vendosur për të garantuar se ndërmarrja i respekton të gjitha ligjet në zbatim gjatë kryerjes së detyrave;
  - o) Të identifikojë, me kërkesë të KE, shenjat adekuatë, në mënyrë që të matet rregullisht performancen e shoqërisë;
  - p) Të sigurojë se veprimtaria e Kompanisë nuk devijon nga qëllimi që parashihet sipas Statutit pa autorizimin e qartë të Komisionit komunal të Aksionareve;
  - q) Bordi i drejtoreve mund të udhëzojë KE në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendimmarrës së bashku me zyrtarët e ndërmarrjes, dhe me propozim të KE mund, të caktojë zyrtarë të tjera (përveç KE, ZLF, sekretarit dhe zyrtari për auditim të brendshëm), duke vendosur detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

#### 4. Mbledhjet

- a) Bordi drejtoreve duhet të mblidhet në vendin e caktuar sipas njoftimit me shkrim për mbledhje, në zyrën e regjistruar të ndërmarrjes apo diku tjetër, kurdo që paraqitet nevoja nga ana e kryesuesit apo nga dy (2) e më shumë drejtore. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë rendin e ditës dhe duhet të dorëzohet me dorë së paku tre ditë para mbledhjes, në mënyrë elektronike apo me çfarëdo mënyre tjetër, të cilat sigurojnë pranimin me kohë. Në raste të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillët me shkrim dhe të dërgohet me dorë, me faks apo email së paku një ditë para mbledhjes.
- b) Në mbledhje, kryesuesi i Bordit të drejtoreve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, duhet të përcaktojë prezencë e kuorumi, të drejtoj debatin, të mbajë procesverbalin, dhe të përcaktojnë dhe deklarojë rezultatet e votimit. Sekretari do asiston kryesuesit, përveç nëse çështja e kofidencialitetit kërkon që drejtori të veproj si sekretar i mbledhjes.
- c) Mbledhjet e Bordit të drejtoreve janë të rregullta dhe valide, me prezencën e shumicës së drejtoreve dhe votimin e shumicës së drejtoreve pjesëmarrës në mbledhje.
- d) Drejtorët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe drejtorët të cilët kanë paraqitur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numërim. Në rast barazimi me vota, kryesuesi i Bordit të drejtoreve duhet të ketë votën vendimtare.
- e) Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë të pranishëm, të udhëheq mbledhjen, dhe të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;
- f) Sekretari i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përceptojë ngjarjet në mënyrë adekuate gjatë mbledhjes.

- g) Pjesëmarrësit duhet të janë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, e gjithashtu edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumente që ndërlidhen aty (nëse ka).
- h) Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga shumica e drejtorëve në zyrë, do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse vendimi që ka kaluar në mbledhjen e Bordit të drejtorëve, që është thirrur dhe mbajtur. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve që kanë formë dhe përbajtje identike, secili i nënshkruar nga një apo më shumë drejtorë.

## 11. Komisioni i auditimit

### Neni 16.

Komisioni i auditimit formohet dhe ka përgjegjësi dhe të drejta, siç janë të përcaktuara në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

## 12 Zyrtarët

### Neni 17.

1. Zyrtarët e NPK "Trafiku Urban ", SH.A., Prishtinë janë: kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor financiar dhe i thesarit, zyrtari i auditimit të brendshëm, sekretari korporativ dhe zyrtarë të tjera të caktuar nga Bordi i drejtorëve, në pajtim me Statutin e ndërmarrjes dhe aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.
2. Pranueshmëria e zyrtareve bëhet në pajtim me aktet e cekura në paragrafin 1 të këtij nenit të bazuar në dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjin e punës në fuqi.
3. Kryeshefi ekzekutiv:

- a) Kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes (KE) ka autoritet që të lidhë kontratë për ndërmarrjen, në pajtueshmëri me ligjin, statutin dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e nenit 192, paragrafi 192.1, pika c, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
- b) Organizimi i kompanisë bëhet në mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e KE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të ndërmarrjes dhe vendimet e të Bordit të drejtorëve. Të gjitha çështjet në lidhje me ndërmarrjen të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit komunal të Aksionareve, Bordit të drejtorëve, Komisionit të auditimit /zyrtarit të auditimit të brendshëm, do të vendosen me përgjegjësitë të KE.
- c) KE do të ketë autoritetë të punësojë apo të largojë nga puna zyrtarët dhe stafin e ndërmarrjes përveç zyrtareve të cilët zgjidhen nga Bordi i drejtorëve apo Komisioni i auditimit.
- d) Këshillon dhe merr pjesë në Bordin e drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe planet e saja strategjike afatgjata;
- e) T'i propozon Bordit të drejtorëve kandidatë të përshtatshëm për emërim si ZKFTH dhe sekretar;
- f) T'i Dorëzon, Bordit të drejtorëve sipas përgjegjësive të tij projekte të dokumenteve që parashikohen sipas nenin 3 (pika 4)(k)(i) dhe nenin 3 (pika 4)(k)(ii);
- g) T'i ofron kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në muaj, Bordit të drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra nga ndërmarrja dhe për

vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti lidhur me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;

h) T'i dorëzon, nën përgjegjësin e tij/saj, Bordit të drejtorëve dokumente, letra dhe informacione lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;

i) Bëjë matjen e performancës së ndërmarrjes dhe i ofron Bordit rregullisht, së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes ndaj klientëve të saj;

j) Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe alokimin e fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjes, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarve në ndërmarrje;

k) Ofron Komisionit të auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;

l) Ofron zyrtarit të auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohen nga ai

m) Kryen detyra dhe punë të tjera të caktuara me ligjet në fuqi.

4. Zyrtari kryesor finansiar i kompanisë ("ZKFTH") do të menaxhojë, në drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të ndërmarrjes. Varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për ndërmarrje dhe do të jetë përgjegjës që:

- a) të mirëmbajë llogaritë e kompanisë të azhuruar dhe të sakta,
- b) të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore,
- c) të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale,
- d) të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e ndërmarrjes dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- e) të përgatisë të dhënët e ndërmarrjes për auditim në fund të vitit;
- f) të rishikojë, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;
- g) të koordinojë funksionet tjera të veprimtarisë, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve;
- h) të menaxhojë thesarin e ndërmarrjes;
- i) të vendosë dhe përgatitë buxhetet dhe
- j) të kryejë edhe punë dhe detyra të tjera të caktuara nga KE.

5. Nën mbikëqyrjen e Komisionit të auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, zyrtari i auditimit të brendshëm të ndërmarrjes, do të jetë përgjegjës për:

- a) udhëheqjen dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së auditimit;
- b) udhëheqjen dhe drejtimin e të gjitha aktiviteteteve të auditimit të brendshëm dhe
- c) përmbushjen çfarëdo detyre tjeter, të përcaktuar nga ana e Komisionit të auditimit.

6. Sekretari i ndërmarrjes do të:

- a) mirëmbajë regjistrin e aksionarëve;

- b) veprojë si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
- c) kryejë të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç mund të kërkohet me ligj ose nga këto statute;
- d) mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurnimin e rregullt të ueb - faqes;
- e) koordinojë me KE përgatitjen e materileve për mbledhjet e Bordit të drejtoreve;
- f) të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të drejtoreve dhe të Komisionit të auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe do t'i shënojë ato në librat e protokolleve. Prosesverbali do të përbajë këto informata: emrat e personave pjesëmarrës, vendin dhe kohën e mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë diskutimit të pikave të vecanta të rendit të ditës, tekstin e vendimeve të propozuara, rezultatin e secilit votim dhe të votave të secilit individ (pjesëmarrës), tekstin e saktë të vendimeve të arritura si dhe çfarëdo kundërshtimi i ngritur në lidhje me vendimet e miratuara.
- g) Prosesverbali për mbledhjet e Komisionit komunal të aksionarëve dhe Bordit të drejtoreve, do të nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes i Bordit dhe nga sekretari dhe do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e radhes. Sekretari do të lëshojë kopje të certifikuara të procesverbalit. Prosesverbali i mbledhjes së do të jetë në dispozicion të aksionarëve dhe drejtoreve, me kërkesën me shkrim;
- Prosesverbali i secilës mbledhje të aksionareve dhe Bordit të drejtoreve do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e radhës të aksionareve dhe Bordit të drejtoreve;
- Prosesverbali i secilës mbledhje të Bordit të drejtoreve do të nënshkruhet nga ana e kryesuesit të Bordit të drejtoreve dhe do t'u shpërndahet anëtarëve të Bordit të drejtoreve. Të njëjtat rregulla do të zbatohen edhe për procesverbalet e Komisionit të auditimit.

### 13. Detyrat e besuara

#### Neni 18.

Secili drejtor dhe zyrtar do të kenë detyra për ndërmarrjen, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë që:

- a) të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;
- b) të ushtrojë fuqinë që i'u është dhënë atyre ekskluzivisht, në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;
- c) të ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tillë, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre;
- d) të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;
- e) të ushtrojë fuqinë që iu është dhënë atyre ekskluzivisht në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;

- f) të ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre;
- g) të shmangë dhe shpalos konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkt apo indirekt) dhe të interesave të shoqërisë;
- h) të ushtrojë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre; dhe
- i) të trajtojë si konfidenciale të gjitha informatat e pranuara me arsyen nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

#### **14. Veprimet e Bordit pa mbajtjen e mbledhjes**

##### **Neni 19.**

Përveç nëse me statut ose rregullore të ndërmarrjes kërkon që një aktivitet i Bordit të ndërmerrë ekskluzivisht në mbledhje të Bordit:

- a) të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerrën në mbledhjet e Bordit mund të ndërmerrën edhe pa mbajtjen e mbledhjes, nëse pëlgimi me shkrim, që përban edhe natyrën e aktivitetit përkatës, nënshkruhet nga të gjithë drejtoret me të drejtë vote për atë çështje,
- b) të gjitha këto pëlgime duhet të përbahen në një ose më shumë miratime me shkrim, të cilat duhet të paraqesin aktivitetin e ndërmarrë, si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtoreve,
- c) të gjitha këto pëlgime duhet të vendosen në procesverbalin e mbledhjes së Bordit të drejtoreve të ndërmarrjes.
- d) pëlgimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtoret, përveç nëse në pëlgim eshtë caktuar një datë tjeter e hyrjes në fuqi.

#### **15. Komisionet e bordit**

##### **Neni 20.**

1. Bordi i drejtoreve, me rregulloren e tij të brendshme, përcakton, kur mund të miratojnë themelimin e një ose më shumë komisioneve, (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve ) që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo-obligative, që janë në kuadër të kompetencës së Bordit.
2. Këto komisione mund të përfshijnë edhe anëtarët e Bordit të drejtoreve dhe të punësuarit në ndërmarrje, si dhe persona jashtë kompanisë, sipas përcaktimit në rregullore.
3. Miratimi i rregulloreve për marrjen e vendimeve të Bordit kërkon një numër më të madh, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorumit eshtë e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjeter të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit, me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit.

## 16. Transparency

### Neni 21.

1. Pas çdo takimi të Bordit të drejtorëve do të lëshoj një raport të shkurtë të hartuar qartë, duke vënë në pah një përbledhje të vendimeve më të rëndësishme dhe rekomandimeve të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet sekret i arsyeshëm; informata të tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur sekretin.

2. Bordi i drejtorëve dhe Komisioni i auditimit rregullisht, së paku çdo tre muaj, hartonë një raport të shkurtër, të qartë, që nxjerr në pah të gjitha rastet në të cilat cilido drejtor apo zyrtar ka deklaruar ekzistimin e konfliktit potencial të interesave dhe ka abstenuar – përbajtura nga votimi ose nga veprimi, duke dhënë indikacione për natyrën e interesave dhe vendimet vepruese për shkak të cilave janë ngritur ato. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahet, nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të ndërmarrjes, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziton nevoja për konfidencialitet. Informacioni nëasnje rrethanë nuk mund të mbahet për shkak të interesave të drejtorit apo zyrtarit përkatës.

3. Komisioni i auditimit rregullisht, së paku çdo tre muaj, harton raport të shkurtë e të qartë, duke nxjerr në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura, të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mosmiratimin e tyre, dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar, duke paraqitur vlerën e transaksioneve; vlerën e bilanceve të papaguara, duke përfshirë kushtet, konditat dhe garacionet; provisionet për borxhet e

dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara, dhe shpenzimet e pranuara gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të pa-pagueshme) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse të ndërlidhura), si dhe deklarata se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për kompaninë. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahen, nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të kompanisë, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme, kur më nuk ekziton nevoja për konfidencialitet. Informacioni nëasnje rrethanë nuk mund të mbahet për shkak të interesave të palës përkatëse të ndërlidhur.

4. Ndërmarrja do të krijojë dhe në mënyrë të rregullt do të azhurojë, në përgjegjësinë e KE një ueb - faqe, ku do të paraqiten së paku këto informacione:

- Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raporti për dokumentet e tilla nga Komisioni i auditimit;
- Raportin nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me LNP;
- Listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet të fundit. Atëherë kur ndërmarrja të veproj në një treg garues, ajo mund të fshijë nga shpalosjet e tilla të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet;

- d) Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raportin për dokumentet e tilla nga Komisioni i auditimit;
- e) Raportin nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me LNP;
- f) Listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual finanziar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidentialitetit. Atëherë kur kompania të veproj në një treg garues, ajo mund të fshin të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet nga shpalosjet e tilla;
- g) Listën e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual finanziar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët tjera (pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidentialitetit që i obligohet këtij të fundit) dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjellë;
- h) Listën e dhjetë (10) furnizuesve më të rëndësishëm të ndërmarrjes, me çmimet e furnizimeve;
- i) Çfarëdo padie në gjyq apo rastet në pritiq në lidhje me vlefshmërinë e çfarëdo zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve ose zyrtarëve, apo vlefshmëria e çfarëdo vendimi të miratuar nga ana e Bordit të drejtorëve;
- j) Të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shpërndahen në paragrafë të ndarë dhe në mënyrë të lehtë për t'iu qasur, me lidhje tek dokumentet tjera kurdo që të jetë e nevojshme, dhe do të përfshihet në një paragraf të vetëm të ueb – faqes, e cila i dedikohet shpalosjeve publike për çështjet e korporatës dhe do të vendosët në një mënyrë të thjeshtë dhe që mund të lexohet leht, secila nga këto në një format që mund të printohet lehtë.

## 17. Llojlojshmëria

### Neni 22.

Viti finanziar i ndërmarrjes do të jetë i njëjtë me vitin kalendarik.

## 18. Detyrimi për mos konkurrencë

### Neni 23.

Zyrtarët dhe drejtorët nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër ndërmarrjes. Kjo konkurrencë përfshinë por nuk kufizohet vetëm në punësimin, të qenit ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë shoqëri tjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkuruese.

## 19. Miratimi i Statutit, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit

### Neni 24.

Ndërmarrja mund të miratojë statut të ri nëse ndryshimi i statutit bëhet mbi 50%, të bëjë ndryshimin, plotësimin, apo ta ndryshojë dhe plotësojë atë me qëllim të harmonizimit të tij me dispozitat e ligjit apo akteve nënligjore.

## 20. Likuidimi i ndërmarrjes

### Neni 25.

Likuidimi i ndërmarrjes bëhet sipas mënyrës dhe formës së përcaktuar me ligj.

## 21. Ushtimi i detyrimeve sipas vendimit personal ose të gjykatës

### Neni 26.

1. Aksionarët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në gjykatë në emrin e ndërmarrjes kundër një ose më shumë drejtorëve ose zyrtarëve, nëse këta aksionarë kanë arsy bindese për të besuar se zyrtarët dhe drejtorët përkatës kanë shkelur detyrën ndaj ndërmarrjes dhe me këtë e kanë dëmtuar ndërmarrjen.

2. Ankesat e paraqitura në këtë mënyrë duhet të përshkruajnë në hollësi ose (i) përpjekjet që janë bërë nga aksionarët për ta shtyrë Bordin e drejtorëve që ta paraqesë ankesën në emër të ndërmarrjes ose (ii) një deklaratë se këto përpjekje nuk janë ngase do të kishin qenë të padobishme, së bashku me një deklaratë ku paraqiten arsyet për mbështetjen e kësaj deklarate.

3. Nëse aksionarët ankues janë të suksesshëm në këtë rast, të gjitha kompensimet e dhëna dhe të pranuara janë pronë e ndërmarrjes.

## II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË HYRJES NË FUQI

### 1. Dispozitat kalimtare

#### Neni 27.

Për çfarë nuk është thën në Statut, do të aplikohen dispozitat e Ligjit nr. 02/L -123, për shoqëritë tregtare, të Ligjit nr. 04/L - 006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L - 123 për shoqëritë tregtare, të Ligjit nr. 03/L - 087 për ndërmarrjet publike dhe të Ligjit 04/L - 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.


### 2. Hyrja në fuqi

#### Neni 28.


Ky statut hyn në fuqi pas dhënies së pëlgimit nga MTI - ja - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

## KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE

1. Rexhep Mustafa



2. Hazir Borovci



3. Luan Jusufi

